



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.661/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Fikrije Mekolli nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Fikrije Mekolli, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me shenjën ZL.Anr.661/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Fikrije Mekolli, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimet në Shkollë “Mihal Grameno”, Shkollë “Selman Riza” në Fushë Kosovë, Shkollë në “Miradi e Epërme”, në shkollën në Miradi të Epërme, në shkollën në fshatin Lismir, në shkollën në fshatin Harilaq dhe Bardh i Madh. Parashtruesja e ankesës kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit të cekura më lart për arsye se dyshimi është shumë i bazuar në vjedhje të votave nga ana e komisionerëve dhe vëzhguesve të PDK-së. Në vazhdim të ankesës ankuesja thekson se këto dyshime janë të bazuara nga deklaratimet e disa votuesve me të cilën i ka kontaktuar gjatë fushatës zgjedhore duke shpalosur programin partiak si anëtare e Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë dhe pas rezultateve preliminare. Në shkollën Mihal Grameno parashtruesja e ankesës pretendon se në klasën ku ka votuar ajo familja e saj nuk rezulton numri i votave të numëruara me ato që familjarët e kanë votuar. Në ankesë ka shënuar disa emra të personave në cilësinë e

dëshmitarëve siç thekson ankuesja kanë shprehur gatishmërinë që përmes rinumërimit të ruajnë votën e tyre dhe të saj. Kërkon nga PZAP-i që të merr në shqyrtim këtë ankesë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimit ankimore të ankueses gjeti se ankuesja me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka specifikuar asnjë vendvotim me të cilën pretendon se janë shkaktuar parregullsitë. Prandaj Paneli ankesat e ankueses i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.661/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*